



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 8  
Prishtinë, më 19 janar 2018, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303-

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Verica Çaraniq, Shqipe Pantina, Albert Kinolli, Andin Hoti, Ali Lajçi, Avdullah Hoti, Faton Topalli dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Blerim Kuçi dhe Mërgim Lushtaku.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Mehmet Simnica.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Vlora Mehmeti, Enver Buqolli, Valmira Jonuzi dhe Senver Morina, ZKA; Mentor Hyseni, GIZ; Hafiz Krasniqi, Bahtir Osmani dhe Labinot Smakaj, KMDK SHA; Ilmi Statovci, Dukagjin Etemi dhe Arben Hetemi, KRM „Pastërtia” Ferizaj.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.12.2017;
3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Kompanisë Rajonale „Pastërtia “ nga Ferizaj, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2017;
6. Shqyrtimi i draft- planit të Punës së Komisionit për vitin 2018;
7. Inicimi i procedurave për Auditimin e raporteve financiare të Subjekteve Politike, për vitin 2017;
8. Të ndryshme.

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.12.2017**

*Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 20.12.2017, u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016**

**Kryetari** paraqiti para deputetëve disa të dhëna nga raporti i auditimit Financiar Vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, dhe me këtë e hapi diskutimin.

**Vlora Mehmeti** paraqiti në pika të shkurtra disa të dhëna sa i përket Raportit Financiar Vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. Duke theksuar se opinionimi është i kualifikuar, dhe se është për herë të parë e audituar kjo kompani nga ZKA. Të gjitha të gjeturat janë të prezantuara në raport, me këto të gjetura është pajtuar edhe kompania Audituese, për këtë kanë përgatitur një plan veprimi të cilin e kanë dorëzuar në ZKA.

**Shqipe Pantina** në cilësinë e raportueses prezantoi para deputeteve dhe të pranishmeve të gjetura e këtij raporti. Duke theksuar se ky është auditim i rregullsisë dhe se opinionimi i auditimit është i kualifikuar. Auditimi është fokusuar në tri çështje kryesore: 1) Pasqyrat Financiare Vjetore, 2) Qeverisjen, dhe 3) Menaxhimin financiar dhe kontrollin, dhe ka nxjerrë këto përfundime: Jo korrektësi/gabime në prezantimin e Llogarive të farkëtueshme në kontabilitet. Nuk janë konfirmuar llogaritë e pagueshme për tatim (mungon raporti nga Administrata Tatimore). Mos përputhje e shumave nga të hyrat e grandit të bartur nga vitet e kaluara. Nuk janë evidentuar me kohë ndryshimet. Evidentim jo të saktë të ekuiteteve, nuk është bërë rivlerësimi nga vitet e kaluara. Paraqitje e gabuar e Aktives/Pasives. Llogaritje e gabueshme e provizionimit të borxheve. Ndonëse edhe në vitin 2016 Auditori kishte dhënë opinion të kualifikuar të pasqyrave financiare.... “nuk ishin vërejtur se ishin ndërmarrë veprime korrigjuese dhe ndarje të provizioneve për borxhet e këqija; dhe nuk ka njohur ndonjë provizion për rastet gjyqësore për shkak të disa padive nga disa furnitorë për mos pagesë të borxheve”. Dobësi të theksuar në llogaridhënie, menaxhim të rrezikut, dhe në cilësi të raportimit menaxherial. Mungon auditimi i brendshëm i cilësisë së lartë. KMDK nuk kishte arritur të zbatojë rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit të jashtëm për vitin 2015, si dhe nuk kishte përgatitur ndonjë plan për menaxhim të rrezikut. Plani biznesit nuk i mbulon të gjitha aktivitetet dhe përmbajta e tij nuk reflekton mundësit reale të ndërmarrjes. Auditori i Brendshëm nuk kishte afuar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontroleve të brendshme dhe nuk kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre. KMDK nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të

auditimit për vitin 2016, asnjë nga 3 rekomandimet e dhëna nuk janë zbatuar ende. Kontrollat mbi menaxhimin e përgjithshëm të KMDK-së kanë nevojë për përmirësime. Auditimi ka vënë në pah mangësi lidhur me pajtueshmërinë me ligje. Buxheti fillestar për investime kapitale, krahasuar me atë final, tregon trend ulës për 50% dhe ky është një tregues i planifikimit jo të duhur për këtë kategori. Keq menaxhim në shpenzimet për Paga dhe mëditje, procedurat e rekrutimit në papajtueshmëri me ligjin, mungese transparencës, konkurrencës dhe trajtim të barabartë në punësim. Mungonte raporti i pranimit të mallrave, miratimi paraprak i kërkesave për blerje, mungonte vendimi për limitimin e shpenzimeve. Keq menaxhim i buxhetit në të gjitha kategoritë. Keq menaxhim i të hyrave në të gjitha kategoritë (licencimi i deponive sanitare, caktimi i tarifave për mbledhjen e mbeturinave). Mangësitë në faturimin e të hyrave. Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike të thërrasë në raportim bordin drejtues të Kompanisë për të shpjeguar defektet dhe për të raportuar me të arriturat në proces të zbatimit të rekomandimeve të Auditorit. Po ashtu propozoi rekomandim që Zyra Kombëtare e Auditorit të bëjë auditim të performancës.

**Faton Topalli** pyeti sa i përket veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA dhe nga Auditimi i Brendshëm? Nga 8 auditime të brendshme vetëm 7 janë kryer dhe ka dhënë vetëm një rekomandim, si arsyetohet kjo?

**Hafiz Krasniqi** u pajtua me të gjitha të gjeturat nga raporti i auditimit, dhe diskutoi për përpjekjet e kompanisë për t'i adresuar. Megjithatë sipas tij dobësi me të theksuar janë se vetëm një pjesë e vogël e shërbimeve po paguhet dhe pamundësia e kompanisë për t'i mbledhur këto borxhe po e vështirëson edhe vetë funksionimin e kësaj kompanie. U përgjigj edhe në pyetjet e parashtruara.

**Kryetari** theksoi se pasi që në takim janë ftuar kryesuesi i Bordit dhe kryeshefi i KMDK SH.A. dhe ata nuk kanë mund të vinë, propozoi që raporti i auditimit për KMDK SHA të diskutohet në takimin e radhës së komisionit.

### *Përfundim*

*KMFP vendosi që raportin e audituar Financiar Vjetor të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës SH.A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të vazhdojë së shqyrtuari në mbledhjen e radhës së komisionit.*

#### **4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Kompanisë Rajonale „Pastërtia ” nga Ferizaj, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016**

**Kryetari** theksoi raportues për këtë raport është deputetja Verica Çaraniq, me këtë e hapi diskutimin.

**Vlora Mehmeti** tha se ZKA e ka kryer këtë auditim, opinioni i ZKA-së për Kompaninë Rajonale „Pastërtia “ nga Ferizaj, është i kundërt për shkak të një sërë shkeljesh të konstatuara. Të gjitha vërejtjet tona janë të paraqitura në raport.

**Verica Çaraniq:** Ky raport ka të bëjë me auditimin e rregullsisë, i cili është i obligueshëm me ligj, dhe përmbledh çështjet e dala nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të KRM ”Pastërtia”. Për PVF-të e KRM ”Pastërtia” për vitin 2016 ZKA ka dhënë Opinion të Kundërt,

për shkak të shkeljeve të shumta të konstatuara. Regjistrim i njëanshëm i transaksioneve. Gjatë vitit 2016, "Pastërtia" kishte bërë faljen e borxheve në vlerë 289,308€. Kjo ka shkaktuar zvogëlim (kreditim) të llogarive të arkëtuara, mirëpo një gjë e tillë nuk ishte përcjellë me regjistrim në anën debi si njohje e provizionit për borxhet e këqija. Një regjistrim i njëanshëm shkakton nënvlerësim të fitimit/humbjes, rrjedhimisht mos barazim të bilancit të gjendjes; Në PVF-të e vitit 2015, KRM "Pastërtia" kishte prezantuar detyrime të tjera afatshkurtra në vlerë prej 662,597€, mirëpo nuk ekzistojnë shënime kontabël lidhur me përbërjen e kësaj vlerë. Për më tepër në vitin 2016, nuk ishte prezantuar asnjë vlerë si detyrime të tjera afatshkurtra dhe nuk ekzistojnë shënime kontabël nëse këto detyrime janë paguar gjatë vitit 2016. Prezantim jo i saktë i aseteve. KRM "Pastërtia" për vite me radhë kishte aplikuar norma të ndryshme të zhvlerësimit të cilat nuk ishin në përputhje me normat e zhvlerësimit sipas Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) ose sipas SNK-ve. Pas rekomandimeve tona në fazën e ndërmjetme të auditimit KRM "Pastërtia" kishte filluar aplikimin e normave adekuate të zhvlerësimit. Mirëpo, përkundër kësaj, vlera neto në libra e cila bartet nga vitet e kaluara nuk është e saktë për shkak të aplikimit të normave jo adekuate të zhvlerësimit; prezantim jo i saktë i kapitalit rezervë. Vlera e kapitalit rezervë e prezantuar në PVF ishte mbivlerësuar për 418,273€ në krahasim me shënimet kontabël. Në PVF kjo rezervë ishte prezantuar 2,506,719€, ndërsa në shënimet kontabël saldo e kësaj llogarie është 2,088,446€. Një mbivlerësim i tillë ishte bërë me qëllim të barazimit të bilancit të gjendjes; mos rivlerësimi i pasurive jo-qarkulluese. Sipas SNK 36 së paku një herë në 3 deri 5 vjet duhet të bëhet rivlerësimi i pasurive. KRM "Pastërtia" që nga viti 2007 nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos njohurive të standardit përkatës. Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për disa nga zërat e prezantuara në pasqyrat financiare vjetore. Mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe letër konfirmimeve nga furnitorët. Në një letër konfirmim të pranuar nga furnitori janë vërejtur mospërputhje me shënimet kontabël. Shuma e borxhit e konfirmuar nga furnitori është 307,497€, ndërsa në shënimet kontabël vlera e borxhit ndaj këtij furnitori është 273,066€, duke rezultuar me një nënvlerësim prej 34,431€. Kjo ka ndodhur si pasojë e regjistrimeve jo të sakta dhe mos harmonizimeve me furnitorët; prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtuara. Vlera e llogarive të arkëtuara të prezantuar në PVF e vitit 2016, paraqet një vlerë jo të saktë pasi që saldo fillestare e cila bartet nga viti i kaluar ishte provizionuar për 176,028€ pa ndonjë kriter apo politike për provizionim; prezantim jo i drejtë i shpenzimeve. Shpenzimet financiare përbëhen nga pagesat për kompensim të komisionit komunal të aksionarit sipas një vendimi të nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Ferizajt, vendim i cili sipas Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL) është pa bazë ligjore. Shuma e paguar për këto kompensime ishte 22,680€. Një gjë e tillë ka rritur shpenzimet pa bazë ligjore. Për më tepër këto shpenzime ishin prezantuar si shpenzime financiare; dhe mos numërimi i stoqeve në fund të vitit. Vlera e stoqeve e prezantuar në PVF është 27,689€. Sipas Ligjit të ATK-së1, çdo tatimpagues kërkohet të bëjë dhe mbajë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. "Pastërtia" nuk kishte bërë vlerësimin dhe regjistrimin e stoqeve në fund të vitit, kjo për shkak se nuk kishin krijuar komision për regjistrim. Ekziston rreziku që vlerat e prezantuara në pasqyra financiare të mos jenë në përputhje me gjendjen faktike të stoqeve.

---

**Dukagjin Etemi** paraqiti në detale të gjitha vërejtjet që ka dhënë ZKA në këtë raport, përpjekjet e kompanisë për adresimin e këtyre të gjeturave, përgatitjen e planit të veprimit nga menaxhmenti dhe caktimin e personave përgjegjës për këtë, si dhe kritikoi auditorët për kohëzgjatjen e auditimit, si dhe trajtimin e kësaj ndërmarrje sikur të ishte institucion publik.

**Vlora Mehmeti** theksoi se kohëzgjatja e auditimit është e përcaktuar me standarde të auditimit dhe metodologjisë që praktikon ZKA, ndërsa sa i përket cilësisë së raportit dhe fushëveprimit të auditimit ZKA ka marrë notë pozitive nga projekti i binjakëzimit që ka monitoruar punën e ZKA-së. ZKA në udhëheqës të ekipit ka pasur auditorë të certifikuar, bazuar në këtë nuk mund të kontestohet cilësia e raporteve.

**Avdullah Hoti** theksoi se nga prezantimi i kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë KRM „Pastërtia” Ferizaj se ka pasur interferime politike në rekrutimin e stafit të kompanisë pa respektuar procedurat. Lidhur me këtë mendoi është papërgjegjësi e kryeshefit dhe paaftësi në menaxhim nëse ka lejuar të ketë interferime politike. Po ashtu kohëzgjatja e auditimit nuk është dashtë ta pengoi menaxhmentin e kësaj kompanie. Po ashtu edhe vendimi për pagesën e anëtareve të caktuar nga aksionari mund të jenë pengesa pa fajin e kompanisë.

**Faton Topalli** tha se sipas raportit thuhet se ka shkelje ligjore brenda kësaj kompanie, nga prezantimi tani i kryeshefit thuhet se ka pasur edhe interferime politike. Pyetja ime është se çka ka ndërmarrë Bordi i Drejtorëve për të adresuar këto çështje?

**Dukagjin Etemi** u përgjigj në pyetje e parashtruara.

**Kryetari** shtoi se sipas raportit ka të punësuar pa konkurs, interferimet politike është dashtë t'i tejkaloji ju si udhëheqës i këtij institucioni. Shpenzime jashtë procedurave të prokurimit. Opinioni i kundërt është dëshmi për një menaxhim jo të mirë brenda kompanisë.

**Ali Lajçi** theksoi për sa i përket masave efektive për të ndërmarr menaxhmenti në adresimin si të çështje së tarifave, auditimit të brendshëm, kontrollit financiar etj. Te kjo kompani, sa janë respektuar rekomandimet e auditorit?

**Zafir Berisha** theksoi se në menaxhimin e këtij sektori është pak telashe, arsye është shumë e thjeshtë. Këto kompani në shumicën e rasteve operojnë me humbje, kanë staf jo të përgatitur profesional, mungesa të mëdha në menaxhimin e të hyrave, vështirësi në inkasimin e të hyrave etj. Të gjitha këto janë pengesa të mëdha edhe për menaxhmentin e këtyre kompanive.

**Kryetari** me këtë përfundim mbylli diskutimin për këtë pikë.

#### *Përfundim*

*KMFP, vendosi që raportin e audituar Financiar Vjetor të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave „Pastërtia” Ferizaj për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të mos e adresoi për seancë plenare, në mbledhjen e radhës së Komisionit do të jepen rekomandimet.*

## **5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2017**

**Kryetari** me këtë pikë njoftoi deputetë se administrata e komisionit ka përgatitur raportin e punës së komisionit për vitin 2017 për periudhën kohore shtator–dhjetor 2017.

*Përfundim*

*KMFP aprovoi Raportin Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2017.*

## **6. Shqyrtimi i draft- planit të Punës së Komisionit për vitin 2018**

**Kryetari** me këtë pikë i njoftoi deputetë se administrata e komisionit ka përgatitur planin e punës së komisionit për vitin 2018 për periudhën janar-dhjetor 2018. Me këtë e hapi diskutimin

*Përfundim*

*KMFP aprovoi Planin Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2018.*

## **7. Inicimi i procedurave për Auditimin e raporteve financiare të Subjekteve Politike, për vitin 2017**

**Kryetari** me këtë pikë njoftoi deputetët se në bazë të Ligjit nr. 04/L-212, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L- 174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-058, neni 11, Kuvendi i Kosovës, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nëpërmjet një thirrje të hapur publike për aplikim, bënë përzgjedhjen e auditorëve, të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës, të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, në përputhje me standardet e kontabilitetit, të zbatueshme në Kosovë. Sipas kësaj baze ligjore NE obligohemi të përgatitmi një kërkesë administrate së Kuvendit për të iniciuar procedurat. Me këtë hapi diskutimin.

*Përfundim*

*KMFP vendosi, duke autorizuar Administratën e Kuvendit, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për thirrje të hapur për aplikim, për përzgjedhjen e së paku 10 auditorëve të licencuar, të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të fushatës së subjekteve politike, për vitin 2017.*

## **8. Të ndryshme**

**Kryetari** pasi nuk pati diskutim në këtë pikë e shpalli të mbyllur takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**  

---

**Driton Selmanaj**